

MENDIM PARALEL

Unë, Olsi Komici në cilësinë e anëtarit të trupës gjyquese në procesin e rivlerësimit kalimtar pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Enerjeta Shehaj, duke qënë dakord me vendimmarrjen përfundimtare në kushtet në të cilat ndodhen faktet, ndaj qëndrim të ndryshëm në lidhje me interpretimin e fakteve dhe konkluzionin në lidhje me një pasuri të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe të pasqyruar në vendim, si më poshtë:

12. Automjet tip “***”, me targa ***, në pronësi të personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit.

Në lidhje me këtë deklaram në vendim pasqyrohet në vija të përgjithshme se ky automjet është përfituar nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 15.11.2016, kundrejt vlerës 300.000 lekë.

Në lidhje me burimin e të ardhurave për blerjen e kësaj autoveture personi i lidhur (bashkëshorti i subjektit), si në deklaratën vetting ashtu edhe në DPV/2016, ka deklaruar se: “... Ky mjet është blerë me të ardhura të kursyera nga paga ime dhe e bashkëshortes...”.

Në shpjegimet dhe provat në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ, të përcjella nga bashkëshorti i subjektit datë 07.01.2022, z. E.SH, por edhe nga vetë subjekti, qartësohet se ata kanë deklaruar në fund të çdo viti gjendjen totale të cash-it deri në atë vit deklarimi dhe jo shtesa apo pakësime, për rrjedhojë për vitin 2016 nuk duhet të konsiderohet shuma e deklaruar në cash prej 350,000 lekë, si shtesë e gjendjes cash, por si gjendje totale e cashit për të gjitha vitet duke qartësuar se shtesa për vitin 2016 është vetëm 50,000 lekë, që përbën diferencën ndërmjet gjendjes cash të deklaruar në DIPP 2016 prej 350,000 lekë minus atë të deklaruar në DIPP 2015 prej 300,000 lekë.

Si subjekti ashtu edhe bashkëshorti i saj në cilësinë e personit të lidhur, por edhe vetë subjekti i rivlerësimit, kanë sqaruar se rrjedha kronologjike e deklarimit të cash ndër vite vërteton faktin se ata gjithmonë kanë deklaruar gjendjen totale të cash-it në DIPP-të përkatëse dhe jo shtesa apo pakësime të cash ndër vite dhe se gjendja e cash-it e deklaruar në deklaratën vetting përkon me përlllogaritjen e deklarimit të cash-it si gjendje totale e cash për ato vite kur është deklaruar gjendje cash.

Përsa argumentuar më lart, subjekti i rivlerësimit pretendon se duke i llogaritur për vitin 2016 gjendjen totale të cash-it për 350,000 lekë, pra si shtesë për këtë vit vetëm të shumës prej 50,000 lekë, subjekti dhe personi i lidhur me të i kanë pasur mundësitë financiare për të blerë automjetin tip “***” në shumën prej 300,000 lekë dhe balanca financiare për vitin 2016 rezulton pozitive.

Nga ana e shumicës së trupës gjyquese, është konkluduar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë kryer deklaram të pasaktë të gjendjes cash ndër vite dhe se shuma prej 350,000 lekë është konsideruar si shtesë në cash për vitin 2016 e për rrjedhojë subjekti dhe personi i lidhur me të kanë rezultuar në pamjaftueshmëri financiare për blerjen e automjetit dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera për vitin 2016, në shumën **-622.181** lekë.

Në lidhje me këtë konkluzion të shumicës së trupës gjyquese nuk jam dakord për arsye se subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar bindshëm dhe në mënyrë shteruese se ajo dhe personi i lidhur me të kanë deklaruar si gjendje cash, shumën totale të cash-it të grumbulluar ndër vite deri në vitin përkatës të deklarimit. Edhe në një përlllogaritje kronologjike të gjendjeve cash të deklaruar me atë të deklaruar në deklaratën vetting del e qartë se kemi të bëjmë me një

deklarim të shumës totale të cash deri në vitin përkatës të deklarimit duke mos deklaruar specifikisht shtesa apo pakësime.

Argumentin tim si më sipër e përforcoj edhe me deklaramet ndër vite të gjendjes cash nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur me të, bashkëshortit të saj, edhe ky subjekt deklarues, konkretisht: a) në DIPP 2010 nga ana e personit të lidhur me subjektin është deklaruar: "...Të ardhura të kursyera nga të ardhurat e përvitshme të siguruara nga unë dhe bashkëshortja ime..."; b) në DIPP 2013, subjekti ka deklaruar: "...Të ardhura të kursyera nga të ardhura të përditshme të siguruara nga unë dhe bashkëshorti sipas ecurisë së tyre në vite...".

Për sa më lart, shpreh mosdakordësinë time në lidhje me vendimmarrjen e shumicës në lidhje me këtë pikë të vendimit duke konkluduar se:

1. Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, bashkëshorti i saj z. E.SH, edhe ky subjekt deklarimi, kanë kryer deklarim të pasaktë të gjendjes cash ndër vite duke mos deklaruar shtesa dhe pakësime, por kjo pasaktësi marrë për bazë përlllogaritjen e gjendjes cash sipas deklarimeve ndër vite dhe korrespondimin me deklarimin e kësaj gjendjeje në deklaratën vetting, konsiderohet me peshë minimale dhe jo deri në atë masë sa ndaj subjektit të rivlerësimit të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra në bazë të pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016;
2. Duke marrë në konsideratë faktin se shtesa e gjendjes cash për vitin 2016 i korrespondon shumës prej 50,000 lekë që vjen si rrjedhojë e diferencës ndërmjet deklarimit të gjendjes cash në DIPP 2016 prej 350,000 lekë me deklarimin e gjendjes cash në vitin 2015 prej 300,000 lekë, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë patur mundësi financiare të mjaftueshme për pagesën e cmimit të blerjes së automjetit prej 300,000 lekë dhe përballimin e shpenzimeve për vitin 2016, duke e gjetur kështu të pranueshëm argumentin dhe analizën financiare për vitin 2016 të bërë nga ana e subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë konstatim.

ANËTAR ME MENDIM PARALEL

Olsi Komici